

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 340, Datë 23.12.2025

MBI

**PEZULLIMIN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR
ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ELENERGJI” SH.P.K. PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 14, pika 10, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2725/8 prot., datë 19.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ELENERGJI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2725 prot., datë 27.10.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 284, datë 06.11.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 08.11.2025 dhe 10.11.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 09.12.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen e internetit të ERE-s.
- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2725/4 prot., datë 20.11.2025. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur ndonjë qëndrim në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.

- Me shkresën nr. 2725/3 prot., datë 14.11.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2725/5 prot., datë 02.12.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues, nga analizimi i të cilit u vlerësua i nevojshëm zhvillimi i një komunikimi të mëtejshëm me qëllim sqarimin e dokumentacionit/informacionit në lidhje me mbështetjen financiare dhe datën e parashikuar të fillimit të operimit dhe korrigjimin e kapacitetit për të cilën i është dhënë VNM-ja Paraprake (kapacitet i cili është më i vogël se ai i përcaktuar në kontratën e koncesionit të ndryshuar dhe për të cilin shoqëria ka njoftuar se ka bërë kërkesën përkatëse pranë AKM-së për korrigjimin e tij). Si e tillë, ERE i është drejtuar shoqërisë nëpërmjet shkresës me nr. 2725/6 prot., datë 05.12.2025, duke i kërkuar depozitimin e sa më sipërcituar.
- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2725/7 prot., datë 12.12.2025, shoqëria ka kërkuar pezullimin e shqyrtimit të aplikimit, deri në depozitimin e dokumentacionit të plotë.

Pezullimi i Afatit të Vendimmarrjes

- Në nenin 14, pika 10, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, *parashikohet se Bordi i ERE-s, rast pas rasti, pas fillimit të procedurës, mund të vendosë të pezullojë vendimmarrjen e tij.*
- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet të pranohet kërkesa e shoqërisë dhe të pezullohet vendimmarrja e bordit të ERE-s për kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.
- Për sa i përket afateve për pajisje me VNM, në referencë të VKM-së nr. 686, datë 29.7.2015 *“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”*, vlerësohet që shoqërisë t’i lihet detyrimi për të depozituar në ERE qëndrimin e AKM-së në lidhje me korrigjimin e kapacitetit të instaluar brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve. Brenda këtij afati, shoqëria duhet të depozitojë dhe dokumentacionin tjetër të munguar të aplikimit, në lidhje me mbështetjen financiare dhe datën e fillimit të operimit.
- Me depozitimin e dokumentacionit të munguar nga ana e shoqërisë, do të rishikohet ky vendim dhe do të bëhet analiza përkatëse e dokumentacionit të aplikimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pezullojë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Bushtrica 1”,

me kapacitet të instaluar 5,226 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushticë, në Qarkun e Elbasanit.

2. Brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve, shoqëria duhet të depozitojë në ERE qëndrimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për korrigjimin e kapacitetit të instaluar dhe dokumentacionin tjetër të munguar të aplikimit.
3. Ky vendim është objekt rishikimi me depozitimin nga ana e shoqërisë të dokumentacionit të munguar.
4. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “ELENERGJI” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI